



DALËSE-IZLAZNA-OUTGOING	
REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA	
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA	
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije	
Ministry of Local Government Administration	
Nr. Br. No.	0201-1240
Data Datum Date	16.11.2012

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Prishtinë, 14 nëntor 2012

Për: Ramadan Muja, Kryetar i Komunës së Prizrenit
Nijazi Kryeziu, Kryesues i Kuvendit të Komunës

Lënda: Shkresë ligjore,

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), me datë 01.11.2012 ka pranuar një kërkesë nga z. Hajrulla Çeku, Drejtor Ekzekutiv i OJQ-se "Ec Ma Ndryshe", lidhur me vendimin e marr nga Kuvendi i Komunës së Prizrenit, për ndërtimin e banesave kolektive në lagjen Dardania" dhe mosrespektimin e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të datës 22 dhjetor 2010 nga ana e autoriteteve komunale.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), bazuar në kompetencat dhe mandatin ligjor për mbikëqyrje të Komunave në realizimin e kompetencave të tyre, të përcaktuar me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe Rregulloren Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (shtojca XII), konstaton se;

- Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese Nr. Ref: RK 77/10, i datës 22.12.2010, vlerëson se Vendimi Nr. 01/011-3257 i datës 30 prillit 2009 i nxjerrë nga Kuvendi Komunal i Prizrenit ka qene i kundërligjshëm. Gjykata ka kërkuar që brenda gjashtë muajve Kuvendi i Komunës së Prizrenit, t'i dorëzoj Gjykatës informata për masat e ndërmarra për zbatimin e këtij Aktgjykimi.
- Kapitulli i VIII të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, thotë se te gjitha vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë te detyrueshme për institucionet e Republikës se Kosovës dhe duhet te zbatohen dhe si te tilla ato janë te pakontestueshme; dhe
- Sipas kapitullit X të Kushtetutës së Republikës së Kosovës konkretisht nenit 124 pika 6, Komunitat obligohen të respektojnë Kushtetutën, ligjet, dhe të zbatojnë vendimet gjyqësore.

Prandaj, MAPL *Kërkon* nga Kryetari dhe Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Prizrenit, të na njoftojë për hapat e ndërmarrë për zbatimin e vendimit të lartshënuar të Gjykatës Kushtetuese.

MAPL, është e përkushtuar të ofrojë përkrahje dhe ndihmën e nevojshme, për zbatimin e plotë të këtyre obligimeve që dalin nga legjislacioni i zbatueshëm për vetëqeverisje lokale në Republikën e Kosovës.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendës Kryeministër & Ministër i MAPL-së

Kopje: Besnik Osmani Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së,
Hajrulla Çeku, Drejtor Ekzekutiv i OJQ-se Ec Ma Ndryshe
Drejtorëve të Departamenteve
Arkivit të MAPL-së.

Prizren, 11 novembër 2012